



04.11.2015

Realizohet Vizita Studiuese në katër Shkolla të Austrisë, financuar nga ADA-Zyra ndërlidhëse e Austrisë, në bashkëpunim me QAPA- Qendra për Avancimin e Performancës së Arsimit.

Nga 26-30 tetor 2015, trajnerët e programit SIVET, realizuan një vizitë studiuese në COOL- shkollat Gjithpërfshirëse/Inkluzive të Austrisë.

Qëllimi i kësaj vizite ishte që të njihemi me shkollat gjithpërfshirëse/inkluzive të Austrisë, respektivisht shkollat që punojnë me metodën COOL.

Gjatë kësaj vizite kishte biseda, prezantime dhe shembuj të ndryshëm që ndërlidhin me zbatimin e metodës COOL, dhe efektin e saj në suksesin e nxënësve.

Georg Neuhauser - Udhëheqës i Qendrës "Mësimnxenia e hapur dhe në bashkëveprim" Steyr-Austri, ishte dhe Shoqëruar i Programit gjatë vizitës katër ditore në Austri.

Gjatë vizitës në këto shkolla, katër trajnerët e SIVET- it, nga Kosova: Sami Bunjaku, Liridon Avdullahu, Vlora Karavidaj dhe Mirjeta Hasani u noftuan për së afërmë se si po zbatohet metoda COOL dhe rëndësinë e saj në stimulimin e nxënësve për të marr pjesë në aktivitetet mësimore. Kjo ishte një përvojë e mirë, sepse koncepti gjithpërfshirje dhe qasja e shkollave gjithpërfshirëse përfat të keq vazhdon të jetë një sfidë e madhe për sistemin tonë arsimor.

Ata po bëjnë përpjekje që që këto përvoja t'i sjellin në shkollat tona përmes zbatimit të metodës COOL, dhe të gjitha strategjive bashkëkohore në mënyrë që shkolla të jetë shtëpi e të nxënët përfatë gjithë pa kurrfarë dallime. Në fakt, kjo

metodë inkurajon nxënësit për të nxënë me sukses njohuritë e reja duke zhvilluar edhe personalitetin e tyre.

Qasja e nxënësve ndaj kësaj metode na bënë të kuptojmë se ekzistonë të gjitha parakushtet që edhe në shkollat tona, suksesshëm të zbatohet metoda COOL. Trajnerët mendojmë fuqishëm se është arritur qëllimi i Projektit sepse ata tashmë kan një eksperiencë në njohjen e filozofisë së metodës COOL, gjegjësisht praktikave të mira gjithëpërfshirëse në shkollat tona.

Foto nga takimi me mësimdhënësit dhe nxënësit e shkollës së Mesme Hainburger Straße në Vjenë



Foto nga takimi me mësimdhënësit dhe nxënësit e shkollës së Mesme Hainburger Straße në Vjenë



Foto nga takimi me mësimdhënësit dhe nxënësit e shkollës së Mesme Hainburger Straße në Vjenë



Vizitë shkollës qëndrore “Ybbs/ Donau”



Foto nga vizita në shkollën profesionale në Rohrbach

